

L I G J
Nr. 9596, datë 27.7.2006

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 “PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 7 të nenit 17/2 “Detyrat e Policisë Tatimore” shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:
“7/1.Verifikon në vend numrin e punonjësve të punësuar te punëdhënësi dhe vendos penalitetet e përcaktuara në nenin 52/3 të ligjit për çdo punonjës të padeklaruar në administratën tatimore.”.

Neni 2

Pika 2 e nenit 30 “Pajisja me certifikatë tatimore” ndryshohet si më poshtë:
“2. Për t’u pajisur me certifikatë tatimore, tatimpaguesi duhet të paraqesë vetëm vendimin e gjykatës dhe të plotësojë formularin “Kërkesë për regjistrim”. Administrata tatimore përpunon kërkesën për certifikatë tatimore brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Tatimpaguesi regjistrohet vetëm një herë, në çastin e fillimit të veprimtarisë ekonomike.

Nëse tatimpaguesi nuk pajiset me certifikatë tatimore brenda pesë ditëve pune, ai quhet i regjistruar.”.

Neni 3

Pika 3 e nenit 30 “Pajisja me certifikatë tatimore” shfuqizohet.

Neni 4

Pas nenit 52/2 shtohet neni 52/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 52/3

**Shkeljet dhe dënimet për mosregjistrimin ose mosdeklarimin e punonjësve
për sigurimet shoqërore e shëndetësore**

1. Mosdeklarimi i çdo punonjësi në administratën tatimore konsiderohet shkelje dhe përveç detyrimit për pagimin e shumës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të papaguara apo të tatimeve të papaguara, dënohet edhe me 10 000 (dhjetë mijë) lekë gjobë për çdo punonjës të padeklaruar. Në këtë rast, gjoba për çdo punonjës të padeklaruar vendoset në vend nga punonjësi i Policisë Tatimore apo çdo punonjës tjetër i administratës tatimore, i autorizuar për këtë qëllim.

2. Vlerësimi i shumës së kontributeve apo i shumës së tatimeve, që duhet të paguajë tatimpaguesi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet nga punonjësit e vlerësimit, në bazë të të dhënave të punonjësve të Policisë Tatimore apo të çdo punonjësi tjetër të administratës tatimore, të autorizuar me shkrim për kontrollin e numrit të punonjësve.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5016, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**